

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4352
Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RENDIN SHTËPIAK NË QENDRËN E SHËRBIMIT ME QYTETARË

Qëllimi i këtij akti ka të bëjë me përcaktimin e rregullave të sjelljes dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët nga nëpunësit civilë në Qendrën e Shërbimit me Qytetarë, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2011 për organizimin dhe funksionimin e Qendrave për Shërbim me Qytetarë, dhe përcaktimin e hyrjeve-daljeve të zyrtarëve dhe palëve në Administratën Komunale.

I. Rregullat e sjelljes së nëpunësve civilë në Qendrën e Shërbimit me Qytetarë:

- a. Komunikimi korrekt dhe i paanshëm me qytetarë në gjuhët zyrtare,
- b. Lehtësimi i qasjes së qytetarëve në shërbime,
- c. Ofrimi i këshillave juridike për qytetarë,
- d. Mundësimi i qasjes së qytetarëve dhe bizneseve në internet,
- e. Informimi i palëve në çdo kohë rreth kërkesës së parashtruar
- f. Respektimi i Kodit të mirësjelljes,
- g. Respektimi i Kodit të veshjes nga nëpunësit civilë (QSHQ),

II. Sigurimi i hyrjeve në Qendrën e Shërbimit me Qytetarë dhe në hyrjen zyrtare të Administratës Komunale


- a. Në hyrjen e Qendrës së Shërbimit me Qytetarë, sigurimi përcjell hyrjen dhe daljen e qytetarëve dhe kujdeset për orientimin e qytetarëve nëpër sportele,
- b. Në hyrjen e pjesës zyrtare, sigurimi fizik përcjell hyrjet dhe daljet e palëve, të cilët kanë termine me drejtorët e drejtorive apo me zyrtarë të administratës komunale,
- c. Orari i pranimit të palëve fillon nga ora 13.30 deri në ora 15.00,
- d. Sigurimi fizik pas orës 8.30 deri në orën 11.45 nuk duhet ta hapë portën për zyrtarët pa u regjistruar në aparatin përkatës dhe e njëjta gjë vlen prej orës 13.15 deri në ora 15.45,
- e. Për respektimin e pikës nën d. kujdeset Sektori Teknik,
- f. Palët do të pajisen me kartela të vizitorëve nga sigurimi fizik për takimet me zyrtarët komunalë dhe me drejtorë të drejtorive të kërkuara,
- g. Dalja në terren e punëtorëve bëhet me lejen e drejtorit /personit të autorizuar.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës–Qendra për Shërbim me Qytetarë, Sektori Teknik dhe drejtoritë komunale përkatëse.

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës – Qendra për Shërbim me Qytetarë, Sektori Teknik, drejtoritë komunale përkatëse, si dhe Arkivi.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4353
Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të datës 8.3.2013, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Muaji prill shpallet muaj për regjistrim falas për të peregjistruarit dhe fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor nga radhët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE).

Neni 2

Lirohen nga taksat administrative për regjistrimin e fëmijëve të peregjistruar deri më tani dhe fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor nga radhët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) gjatë muajit prill të vitit 2013.

Neni 3

Obligohet Zyra për Informim e Komunës së Prizrenit për informimin e qytetarëve lidhur me përmbajtjen e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës –Sektori i Ofiqarisë, Zyra për Informim, Zyra për Kthim dhe Komunitete dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës –Sektori i Ofiqarisë, Zyra për Informim, Zyra për Kthim dhe Komunitete, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me uniforma për stafin e Qendrës së Shërbimit për Qytetarë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës për lejimin e furnizimit me uniforma për stafin e Qendrës së Shërbimit për Qytetarë, përkatësisht për furnizim me 60 copë këmisha si dhe 30 copë kravata, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me drejtoritë komunale më 2.4.2013, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 18.3.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale, trotuareve dhe kanalizimeve, me participim, në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë:

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 18.3.2013, për lejimin e ndërtimit të disa rrugëve lokale, trotuareve dhe kanalizimeve, me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës “Fatmir Berisha”, -lagjja “Bajram Curri”;
2. Rrugës Lagjja “Sopa”-fshati Zhur-te shkolla;
3. Rrugëve lokale në fshatin Caparc;
4. Rrugës “Elbasani”-lagjja “Bajram Curri”;
5. Rrugës lagjja “Ukaj”-fshati Korishë;
6. Kanalizimit dhe trotuarit në fshatin Gjonaj;
7. Kanalizimit në fshatin Nashec-faza e II;
8. Kanalizimit në rrugën e “Koshares”;
9. Rrugës “Besim Shala”-anësore, në lagjen “Jeta e Re”;
10. Rrugëve lokale në fshatin Vlashne, dhe
11. Rrugëve lokale në fshatin Atmaxhë e Vogël - “Abaz Shala”.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për pastrimin e hedhurinave në prrockat e fshatit Lybeçevë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e pastrimit të hedhurinave në prrockat e fshatit Lybeçevë, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows a circular official stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top, "KOMUNA E PRIZRENIT" at the bottom, and "PRIZREN" in the center. A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e shpalljes së tenderit për organizimin e Festivalit të Valleve Popullore për nxënës të shkollave, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e organizimit të Festivalit të Valleve Popullore për nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e shpalljes së tenderit për organizimin e Festivalit - Loja Skenike, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e organizimit të Festivalit - Loja Skenike për nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-4354

Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, si dhe të Memorandumit të mirëkuptimit nënshkruar me datë 29.10.2010 në mes të Komunës së Prizrenit, Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Zyrës Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për Qendrën Mësimore “Jeta e Re” dhe “Terzi Mahalla” për komunitetin RAE, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Lejohen mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve për Qendrën Mësimore “Jeta e Re” dhe “Terzi Mahalla” për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) në shumën prej 15.000 € për vitin 2013.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga:

- a. Pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës në shumën prej 5000 €,
- b. Pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shëndetësisë në shumën prej 5000 € dhe
- c. Pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete në shumën prej 5000 €.

Neni 3

Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës që në bashkëpunim me Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave dhe drejtoritë e lartcekura që të sigurojnë mjetet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi, si dhe të gjejnë modalitetet për pagesë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe drejtoritë e lartcekura.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4356
Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për formimin e komisionit për monitorimin e ndërtimit të Shkollës së Kompetencës në lagjen "Dardania", kryetari i Komunës, me 2 prill 2013, mori këtë

A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni profesional për monitorimin e ndërtimit të Shkollës së Kompetencës në lagjen "Dardania". Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Veron Aliu, nga DKA,
- b. Ejup Kryeziu, nga DSHP, dhe
- c. Refki Musbegu, nga DUPH.

II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë: të bëjë monitorimin e punimeve si dhe konsultime me mbikëqyrësin e Qeverisë së Luksemburgut, të mbajë shënime dhe ato (vërejtje, sugjerimet, etj.) t'i prezantojë në mbledhjet që mbahen me përfaqësuesit e Qeverisë së Luksemburgut.

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, investitori, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramdan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për themelimin e Muzeut Etnologjik në Prizren, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

I. Lejohet inicimi i procedurave ligjore për marrjen e vendimit për themelimin e Muzeut Etnologjik në Prizren.

II. Muzeu Etnologjik planifikohet që të vendoset në shtëpinë-objektin e rinovuar dhe restauruar të Hysen Sheh Zades në Prizren.


III. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, që në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtorinë për Zhvillim dhe Turizëm, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Zhvillim dhe Turizëm.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Zhvillim dhe Turizëm, KPF-ja, Kuvendi i Komunës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4357
Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 19.3.2013, për përkrahje financiare të Klubit të karatesë "Drini" nga Prizreni, me qëllim të pjesëmarrjes në Kampionatin botëror të karatesë që mbahet në Stamboll të Turqisë, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 19.3.2013, bazuar në kërkesën e Klubit të karatesë "Drini" nga Prizreni për përkrahje financiare, me qëllim të pjesëmarrjes në turneun e karatesë që mbahet nga data 5 deri me 7 prill 2013 në Stamboll të Turqisë, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 1000 €.

Neni 2

Mjetet e cekura si në nenin 1 të këtij vendimi do të lejohen pas parashtrimit të pëlqimit të dhënë nga ana e Federatës së Sporteve të Kosovës për shkuarjen e KK "Drini" në Stamboll të Turqisë me qëllim të marrjes pjesë në këtë turne.

Neni 3

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave dhe shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KK "Drini" si dhe arkivi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-4358

Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 19.3.2013, rreth lejitimit të mjeteve për mbështetje financiare për Festivalin folklorik “Hasi Jehon-2013”, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 19.3.2013, bazuar në kërkesën e ShKA “Malësori” rreth lejitimit të mjeteve për mbështetje financiare për Festivalin Folklorik “Hasi Jehon-2013”, i cili pritet të mbahet me 2,3, dhe 4 maj 2013 në fshatin Gjonaj, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 5000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, ShKA “Malësori”, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4359
Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa për formimin e Komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet Komunale nr. 01/011-4099, kryetari i Komunës, më 2 prill 2013, miratoi këtë:

AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet Komunale nr. 01/011-4099 të datës 18 qershor 2009. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen: 1. Fehmi Dërguti, nga DEF, 2. Miradije Meta, nga DEF, 3. Visar Islamaj, nga DA, 4. Xhelal Susuri, nga DASH, 5. Laura Suka, nga DShP, 6. Dukagjin Berisha, nga DGjK, 7. Reshat Mehmeti, nga DPMS, 8. Dashurie Memçaj, nga DI dhe 9. Mubexhele Zhuri nga ZÇGj, anëtarë. Anëtarët e lartcekur, në mbledhjen e parë do të zgjedhin kryesuesin e komisionit.

II. Detyrat e komisionit do të jenë: caktimi i taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste për biznese, të shqyrtojnë dhe analizojnë të gjitha tarifatat aktuale dhe pas analizës të propozojnë dhe arsyetojnë tarifatat e reja konform ligjeve pozitive.

III. Ky Komision do t'ia propozojë kryetarit të Komunës Draftregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet Komunale nr. 01/011-4099, të datës 18 qershor 2009, me propozim që kjo të procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

IV. Afati i hartimit të Draftregullores së lartcekur do të jetë 30 ditë, nga dita e marrjes së aktvendimit.

V. Këshillë juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mija

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 20.3.2013, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për OJQ "Handikos" me qëllim të furnizimit me naftë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 20.3.2013, bazuar në kërkesën e OJQ "Handikos", për përkrahje financiare për furnizim me karburant-naftë, për nevojat e kësaj OJQ-je, kështu që, i lejohej OJQ "Handikos", që të furnizohet me karburant-naftë në vlerë deri në 1000 €, te operatori ekonomik, i cili bën furnizimin e Komunës me karburante.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori Teknik dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori Teknik, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, OJQ "Handikos" si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-4360

Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 20.3.2013, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për Arlind Durajn nga Prizreni, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 20.3.2013, bazuar në kërkesën e Arlind Durajt rreth lejimit të mjeteve për përkrahje me qëllim të furnizimit me gjëra ushqimore elementare për fëmijët e porsalindur, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-4361

Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Çështje Gjinore, rreth lejitimit të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve operacionale të Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren, kryetari i Komunës, më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Çështje Gjinore, rreth lejitimit të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve operacionale (rryma, uji, higjiena, mirëmbajtja) të Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren, kështu që për mbulimin e shpenzimeve të lartcekura, lejohen mjetet e nevojshme financiare për pagesë të këtyre shpenzimeve dhe atë për periudhën gjashtëmujore të këtij viti.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe se pagesa do të bëhet pas parashtrimit të faturave.

Neni 3

Sigurimin e lëndës djegëse-dru për ngrohjen qendrore për Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren do ta bëjë Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale në afatin e duhur kohor.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3701
Më 2.4.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.4.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, të datës 21.3.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me pjesë për automjete, servisim dhe riparim të automjeteve të ShZSh-së, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 21.3.2013, për lejimin e furnizimit me pjesë për automjete, servisim dhe riparim të automjeteve të ShZSh-së, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E KOSOVËS', 'KOMUNA E PRIZRENIT', 'Kryetari i Komunës', and 'Prof. dr. Ramadan Muja'. A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4362
Më 22.3.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Orhan Lopar, nënkryetar i Komunës për Komunitete, të datës 22.3.2013 rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Turqi dhe pagesës së mëditjeve e shpenzimeve të udhëtimit (biletës së aeroplanit), kryetari i Komunës, më 22 mars 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Orhan Lopar, nënkryetar i Komunës për Komunitete, të datës 22.3.2013, për lejinin e udhëtimit zyrtar, për në Komunën e Eskishehir të Republikës së Turqisë, me qëllim të pjesëmarrjes në Festën e Ditëve të Novruzit, që mbahen nga data 20 mars deri me 24 mars 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për ditët e lartcekura dhe pagesa e shpenzimeve të udhëtimit (biletës së aeroplanit), për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës për Komunitete dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës për Komunitete, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-4363
Më 2.4.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Shoqatës për Përparimin e Medieve “Shadërvani” për mbështetje financiare të projektit “Rinia-vështirësitë dhe e ardhmja e tyre”, kryetari i Komunës më 2 prill 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet kërkesa e Shoqatës për Përparimin e Medieve “Shadërvani” për mbështetje financiare të projektit “Rinia-vështirësitë dhe e ardhmja e tyre”, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

